



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E KULTURES
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 476 Prot.

Tiranë, më 03.042018

VENDIM Nr. 68, datë 20.03.2018

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.4, datë 20.03.2018, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Antigone"2018*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), drejtues Prof. Dhimitër Çondi, paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë.

VENDOSI:

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Antigone"2018*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), drejtues Prof. Dhimitër Çondi, paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Sondazhe për të përfituar elemente të rinj arkitekturorë e urbanistikë, banesa, rrugë, hyrje dhe material arkeologjik, që do të hedhin dritë mbi historinë ekonomiko-politike, administrative e kulturore në Antigone;
 - Sondazhe që do të mundësojnë zbulimin e monumenteve si Teatri, Tempulli dhe Nekropoli, mjaft të domosdoshëm, që i mungojnë për momentin Antigonesë;
 - Pastrimi i një tempulli ekstra urban jashtë sistemit fortifikues të qytetit;
 - Sondazhe në Akropol, që do të sqarojnë aspekte kronologjike mbi fillesat e jetës në Antigone.
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të ajo e nevojshme për kryerjen e tyre, brenda vitit 2018.

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al

3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

